



Disiplina pozitive!

Është e rëndësishme që prindërit të ndërjegjësohen për rëndësinë e sjelljeve pozitive. Disiplina dhe Ndëshkimi, janë dy skaje të kundërta të edukimit.

Ndëshkimi ka për qëllim që të kontrollojë sjelljen nëpërmjet shkaktimit të dhimbjeve fizike dhe /ose psikologjike. Është një mënyrë reaktive. Të rriturit mbajnë në kontroll sjelljen e fëmijëve pa iu dhënë shpjegime dhe pa iu ofruar shembuj të sjelljeve të përshtatshme. Ndëshkimi, qoftë fizik ose psikologjik është dhunim dhe shkelje e të drejtave të fëmijës. Përdorimi i ndëshkimit i dekurajon fëmijët që të mësojnë sjellje alternative pozitive.

Disiplina iu mundëson fëmijëve njohuri dhe aftësi për të kontrolluar dhe për të marrë përgjegjësi për sjelljen e tyre. Disiplina thekson modelimin e sjelljes së duhur, në mënyrë që fëmijët të dinë se cilat janë pritshmëritë për veprimet e tyre. Kjo strategji thekson respektimin e të drejtave të fëmijëve. Disiplina thekson mirëkuptimin, komunikimin dhe i shikon gabimet e fëmijëve si një mundësi për të përmirësuar sjelljen

Në vijim, pasqyrohen efektet e këtyre dy teknikave, duke rekomanduar përdorimin e disiplinës pozitive, si forma më e mirë dhe e shëndetshme gjatë rritjes së fëmijëve.

Disiplina Vs Ndëshkimi

Disiplina	Ndëshkimi
Fëmijët kanë mundësi që të zgjedhin mes sjelljeve alternative pozitive	Shpejgon sjellen që nuk duhet ndjekur, pa dhënë arsytet relevante
Është një proces i rregullt, i vazhdueshëm dhe i qëndrueshëm	Ndodh vetëm kur fëmija gabon ose shfaq probleme. Është një veprim i pararendur që ka si qëllim të dëmtojë dhe poshtërojë fëmijën
Sjellja e mirë mbështetet dhe shpërblehet	Reagohet në mënyrë të ashpër vetëm ndaj sjelljes së papërshtatshme
Merr në konsideratë figurën e fëmijës. Së bashku me fëmijën, diskutohet për vendosjen dhe ndjekjen e rregullave	Opinionet dhe mendimet e fëmijës nuk merren në konsideratë. Fëmijët i ndjekin rregullat sepse kërcënohen dhe dhunohen
Udhëzimet e dhëna janë të qëndrueshme dhe të vazhdueshme	Udhëzimet karakterizohen nga kontrolli dhe kërcënimi
Është qasje pozitive, që respekton të drejtat e fëmijëve	Është qasje negative, që dhuron të drejtat e fëmijëve
Shmang dhunën fizike dhe verbale	Karakterizohet nga përdorimi i dhunës verbale dhe fizike
Sjellja e papërshtatshme ndiqet nga pasojat logjike	Pasojat e sjelljes nuk janë të lidhura dhe logjike me veprimet që bëjnë

dhe të drejta	fëmijët.
<p>Fëmijëve iu shpjegohen arsyet e ndjekjes së rregullave dhe në këtë mënyrë, disiplina internalizohet (brendësohet)</p>	<p>Fëmijët i mësojnë rregullat në mënyrë pasive, por e kanë të paqartë të kuptuarin e vërtetë se cila nga sjelljet është e përshtatshme dhe cila jo</p>
<p>Fokuset tek të kuptuarit e nevojave, kapaciteteve dhe staveve zhvillimore të fëmijëve</p>	<p>Është proces i papërshtshëm për të gjitha stadet zhvillimore të fëmijës.</p>
<p>Iu mëson fëmijëve vetë-disiplinimin</p>	<p>``Disiplina`` duhet të përforcohet vazhdimisht nga një i rritur dhe mbahet përmes frikës</p>
<p>Thekson të dëgjuarin dhe modelimin</p>	<p>Përfshin vazhdimisht të qortuarin e fëmijëve</p>
<p>I konsideron gabimet si ngjarje normale dhe si mundësi për të mësuar sjelljen alternative pozitive</p>	<p>Gabimet konsiderohen si të papranushme. Nxit bindjen tek fëmijët dhe jo të kuptuarin mes të drejtës dhe të gabuarës.</p>
<p>Fokuset tek sjellja e fëmijëve në vend të stigmatizimit për shkak të personalitetit</p>	<p>Kritikon personalitetin e fëmijëve dhe nuk fokusohet tek sjellja</p>

